



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. 258/10 Prot.

Pogradec, më 26. 01. 2024

VENDIM

Nr. 4, Datë 25. 01 2024

PER MIRATIMIN E KRITEREVE TË FAMILJEVE NË NEVOJË QË DO TË TRAJTOHEN ME FONDIN DERI NË 6% NGA FONDI I KUSHTËZUAR PËR BLOK-NDIHMËN EKONOMIKE PËR VITIN 2024.

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1/1, 1, shkronja (a) dhe (b), nenit 55, pikat 2 dhe 6 të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"; nenit 21 të ligjit nr.57/2019, "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë", vendimit nr.597, datë 4.09.2019 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike":

**KËSHILLI I BASHKIAK
VENDOSI:**

Të miratojë kriteret mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6% ose me fondet e buxhetit vendor, për vitin 2024.

Përfituesit nga fondi 6% I bllok-ndihmës ekonomike do të përzgjidhen nga familjet aplikuese për ndihmë ekonomike të cilat janë refuzuar nga sistemi elektronik i ndihmës ekonomike pasi kanë marrë pikë të pamjaftueshme, pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme për të jetuar dhe plotësojnë këto kriterë:

1. Të përfitojnë familjet me shumë fëmijë që refuzohen nga sistemi për pikë të pamjaftueshme, me nevoja sociale të theksuara dhe nuk kanë asnjë anëtar të punësuar.
2. Kryefamiljaret gra, të cilat refuzohen nga sistemi për pikë të pamjaftueshme.
3. Beqarët të ngelur vetëm, në moshë mbi 40 vjet, të pamundur për të punuar të cilët janë refuzuar nga sistemi elektronik i ndihmës ekonomike për pikë të pamjaftueshme, pa të ardhura,
4. Familje që kanë në përbërje të tyre persona me aftësi të kufizuar, refuzuar nga sistemi për pikë të pamjaftueshme dhe nuk kanë asnjë të punësuar.
5. Familjarë në prag pensioni që nuk kanë mundësi punësimi dhe janë refuzuar nga sistemi për pikë të pamjaftueshme.

**KRYETARE E KËSHILLIT
Manjola KAMOLLI**

